



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME MAT Sh.a.

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME
TË SHOQËRISË UJËSJELLËS MAT Sh.a.

Nr. 2048

Datë 24/05/2023

Sot, më datë 24 Maj 2023, në Burrel, Mat, Shoqëria Ujësjiellës Mat Sh.a. e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J68103917F, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Artan Thomaraj, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim:
Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujësjiellës Mat Sh.a nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me V.K.M. nr. 302, datë 11.05.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe me marrëveshjen noteriale Rep. 7508, Kol. ska, datë 29.09.2022, midis Shoqërisë Ujësjiellës Mat Sh.a dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër Sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoje ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të çregjistrohet nga regjistri tregtar Q.K.B.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Artan Thomaraj si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETAR

Agron MALAJ

